



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 14, datë 12.02.2020

MBI

**“MIRATIM PËR REDUKTIM, NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË
STUDENTEVE TË CIKLIT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”; urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 77, datë 07.11.2019 “Mbi përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, në Universitetin e Arteve”, Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth Relacioneve të paraqitura nga Fakultetet e UART nëpërmjet Administratores së UART Znj. Alma Sinanaj dhe duke u bazuar në aktet e dala për këtë qëllim, pasi e diskutoi,

VENDOSI:

1. Miratimin për reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, të studenteve të Fakultetit të Muzikës të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2019-2020, sipas lidhjes 1/2 bashkëlidhur vendimit.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



